

Irida Sina

LIBËR PËR MËSUESIN

Teknologji me TIK

8



Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e tetë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. 01B/172, të datës 13.08.2021.



Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

ISBN: 978-9951-786-20-1



9 789951 786201



BOTIME

pegi

Msc. Irida Sina

LIBËR PËR MËSUESIN

TEKNOLOGJI ME TIK 8

Për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2021

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Marigona KRYPA, Nehar SHASIVARI,
Sevdije HAXHIBEQIRI
Korrektorë letrarë: Brunilda MENO, Arlon LIKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elidor KRUIJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN 978-9951-786-20-1

© Botime Pegi sh. p.k, dega në Kosovë, gusht 2021
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara
nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje,
shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht,
pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

Hyrje	5
Plani vjetor	12
Plani dymujor shtator-tetor	15
Plani dymujor nëntor-dhjetor	16
Plani dymujor janar-shkurt	20
Plani dymujor mars-prill	23
Plani dymujor maj-qershor	25
Aspekte të përgjithshme të planit të orës mësimore	28

1. HYRJE

Përmes kësaj fushe të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin për përdorim të teknologjive të TIK-ut, zhvillimit të ekonomisë familjare, orientimit profesional, zhvillimi i ndërmarrësisë dhe edukim për zhvillim të qëndrueshëm. Nxënësit do të mësojnë edhe vetë të punojnë, të hulumtojnë e të krijojnë, të zhvillojnë aktivitete praktike në fushën e teknologjisë.

Në kuadër të lëndës *Teknologji me TIK* do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës *Jeta dhe Puna* për shkallën 4, si: Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Puna dhe Edukimi për ndërmarrësi si dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës *Jeta dhe Puna*.

Përmes Teknologjisë dhe TIK-ut, ndërmarrësisë, orientimit në karrierë, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional (përzgjedhja e profesionit), përdorimit të TIK-ut etj.

Qëllimet kryesore të lëndës së TIK-ut janë:

Në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna* nxënësit zhvillojnë njohuritë, ushtrojnë punën praktike, përdorimin e Teknologjisë dhe TIK-ut, ushtrimin e zhvillimit të ndërmarrësisë si dhe arrijten e kompetencave për vendimmarrje lidhur me orientimin profesional si dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do të udhëheqë mësuesit në zhvillimin e lëndës së Teknologji me TIK në arsimin e mesëm të ulët, në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat edhe në kurrikulën e kësaj lënde.

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është orientimi i mësuesit/es që japin lëndën e Teknologji me TIK në klasën e 8-të, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule dhe zbatimin me sukses i saj kalon nëpër tri elemente mjaft të rëndësishme:

- a) planifikimin e të nxënësve sipas formateve të reja;
- b) zbatimin e metodologjinë e mësimdhënies, bazuar në teknika të mësimdhënies të cilat nxisin bashkëpunimin midis nxënësve;
- c) realizimin e vlerësimit për të nxënë dhe i të nxënësve.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së 8-të, përkatësisht shkalla e 4-rt e lëndës Teknologji me TIK, miratuar nga MASHT-i, më 2019.

Ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të Teknologji me TIK për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatohet në lëndën e tij/saj.
- **të udhëheqë** çdo mësues/e me formatet e planifikimit e kërkuara dhe mënyrën se si ato duhet të

përdoren në lëndën e Teknologji me TIK, duke i udhëzuar ata mbi: **planifikimin vjetor, periudhave ditore, situatat e të nxënësve, format e vlerësimit etj.**, me të cilat duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim ofron modele ose i sugjeron, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim. Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORËT

2. II. Programi mësimor, kompetencat dhe kuptimi i tyre

Ky libër përshkruan në mënyrë të detajuar programin mësimor të Teknologji me Tik, klasa e 8-të dhe udhëheq mësuesin/en për ndërtimin e kompetencave të lëndës së Teknologjisë me Tik-un si dhe të kompetencave kyçe, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën.

Kompetencat kyçe

Fjala kompetencë ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, duke dhënë qartë rolin që ato kanë në përdorimin dhe në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale, në të cilën zhvillohet njohuria. Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson nxënësit të bëhen të aftë dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës. Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë 6 kompetencat kyçe, duke ditur sesi t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit sipas formateve të përcaktuara.

Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç njohurive të Teknologjisë me TIK, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

3. III. Teknika të mësimdhënies

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë, e cila kërkon të japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxisë interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Proces i mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënësve*. Disa nxënës mësojnë përmes *përceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënësve, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënësve këto metoda.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor, duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënës, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënës dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura.

Për të siguruar përdorimin efektiv të TIK-ut mësuesit duhet:

- të planifikojnë përdorimin e TIK-ut nga ana e nxënësve në bashkëpunim me mësuesit e lëndëve të tjera;
- të planifikojnë saktë temat e reja, për të cilat mund të përdoret TIK-u jo vetëm si aftësi kryesore, por edhe si aftësi që ndihmon në arritjen e dijeve në lëndët e tjera;
- të jenë të sigurt se burimet e TIK-ut janë në dispozicion për mësimdhënien dhe mësinxënien;

Është e rëndësishme që kur bëhet planifikimi i përdorimit të TIK-ut për temat e reja, të sigurohemi më parë që nxënësit janë në gjendje ta përdorin atë.

Përdorimi i TIK-ut në mësim rrit cilësinë e mësimdhënies, paraqet një strategji mjaft të rëndësishme për asimilimin e njohurive dhe ofron mundësi për përmirësimin e sistemit arsimor. Nëpërmjet teknologjisë nxënësit aftësohen të hapin bizneset e tyre dhe të përdorin TIK-un për të zhvilluar biznesin online ose për të krijuar kontakte me konsumatorët.

Për këtë arsye, rekomandohet aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe nxënies duke integruar TIK-un në proces vetëm në orët kur shikohet e arsyeshme. Për të realizuar, orë të tilla nevojiten këto pajisje:

Në këto cikle shkollimi është shumë e rëndësishme t'i jepet rendësi faktit që jo të gjithë nxënësit mësojnë njësoj dhe nuk kanë të njëjtat nevoja.

Brainstorming (Stuhi mendimesh)

Brainstorming (stuhi mendimesh) është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështjeje dhe të diskutojnë rreth saj me synim ndërtimin e njohurive të reja. Kjo teknikë siguron një mjedis të lirë dhe të hapur, që inkurajon të gjithë pjesëmarrësit për të shprehur në mënyrë kreative mendimet e tyre rreth një problemi. Teknika (brainstorming) përdoret në fazën fillestare të ndërtimit të njohurive të reja. Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rendisin të gjithë njohuritë, që ata kanë lidhur me temën e re. Në këtë fazë, roli i mësuesit/es është të drejtojë debatin, të kuptojë mendimet e nxënësve dhe të dëgjojë me kujdes idetë e tyre. Përdorimi i kësaj teknike synon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor. Brainstorming është një teknikë e thjeshtë dhe e efektshme, e cila kërkon një nivel të lartë krijimtarie për t'u përdorur. Këtë teknikë, mësuesit mund ta përdorin gjatë kohës që zhvillojnë kryesisht tematikën e ndërmarrësisë apo prezantimit të planit të biznesit. Gjithashtu, mësuesit, gjatë tematikës së prezantimit, mund t'u kërkojnë nxënësve të realizojnë prezantime duke përdorur programe të ndryshme multimediale, dhe më pas t'u kërkojnë nxënësve nga ndryshojnë ato nga njëri-tjetri.

Harta e koncepteve (Konceptograma)

Harta e koncepteve (Konceptograma) është një metodë (teknikë) e paraqitjes vizuale të një informacioni, dhe shërben për lidhjen e koncepteve të një teme mësimore, disa temave apo të një tematike. Përcaktimi me saktësi i kësaj metode (teknike) mundëson qëndrueshmëri në përvetësimin e njohurive, integrimin

logjik dhe aftësinë për zbatimin e tyre, si dhe shprehinë e një pune krijuese. Konceptograma shërben si një instrument diagnostikues i procesit të të nxënësve interaktiv. Konceptogramën mund ta ndërtojme edhe duke filluar nga një koncept specifik dhe të kalojmë te koncepti themelor. Ata mund të jenë dyllorësh: të thjeshta ose të detajuara në degë hierarkike. Elementët përbërës të tyre janë: etiketat, vijat dhe nyjat.

Në etiketa vendosen konceptet, vijat lidhin konceptet dhe përcaktojnë tipin e strukturës së konceptogramës.

Konceptograma zbatohet lehtë në kushtet e mjedisit të një klase. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit hap pas hapi duke mbajtur shënime në tabelë, dhe pasi dëgjon mendimet e tyre, bën vërejtjet përkatëse dhe ndërton një konceptogramë, duke u bazuar në idetë më të mira të nxënësve. Më poshtë po rendisim veprimet që kryen mësuesi/ja gjatë një ore mësimore:

Mësuesi/ja rendit në një tabelë përmes diskutimit me nxënësit të gjitha konceptet që përmban tema apo tematika.
Ai ndërton së bashku me nxënësit diagramin e konceptogramës duke vendosur konceptet në etiketa.
Vendos konceptin më të përgjithshëm në qendër dhe e rrethon atë.
Pyet nxënësit se cilat janë konceptet e tjera, që lidhen me konceptin e vendosur tek etiketa qendrore.
Bashkon etiketat me vija të thjeshta ose vija me shigjeta sipas kontekstit të përmbajtjes së tyre.
Mësuesi/ja mund edhe të udhëzojë nxënësit, që ata të ndarë në grupe të ndërtojnë secili nga një konceptogramë. Në fund të kohës së caktuar, mësuesi/ja kontrollon konceptogramet, dhe ndërton një konceptogramë duke debatuar dhe bërë komentet e duhura me nxënësit për problematikat ose logjikën e ndjekur nga ana e tyre.

Projekte kërkimore

Projekti kërkimor është vlerësuar si metodë tepër pretenduese, realizimi i së cilës kërkon praktikimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vërtetimi, studimi rasti, dhe pse jo, edhe kombinimin e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Për të realizuar këtë teknikë, mësuesi/ja duhet t'u lërë nxënësve në dispozicion disa orë mësimore. Kjo teknikë mund t'u propozohet nxënësve për realizimin e një projekti lëndor, të cilit mësuesit mund t'i lërë në dispozicion disa orë të tre-mujorit. Nuk duhet që orët të realizohen në klasë, ato mund të jepen në formën e detyrave të shtëpisë. P.sh.: kur nxënësit kanë për të trajtuar **temën e krijimit të biznesit të tyre**, ata mund të marrin në Intervistë nxënësit më të rritur, prindërit apo edhe mësuesit për të marrë ide, se si mund të krijojnë një sipërmarrje të tyre. Më pas, të analizojnë të dhënat që do të dalin nga intervistat, dhe më pas duke i diskutuar në klasë të shohin se sa këto të dhëna përputhen me njohuritë lëndore.

Udhëzime për përdorimin e saj:

- Kërkohet të shfrytëzohet informacioni dhe njohuritë e nxënësit nga më shumë se një lëndë.
- Është metodë që vë në përdorim dhe shfrytëzon përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e tyre të marra nga burime jo shkollore.
- Si metodë kërkon që shumë nga veprimtaritë e nxënësve të kryhen jashtë orës së mësimi dhe jashtë mureve të shkollës.
- Projekti kërkimor kërkon përcaktimin e partnerëve pjesëmarrës në arritjen e objektivave. Partnerët mund të jenë mësues/e të lëndëve të tjera, prindër dhe përfaqësues të komunitetit.

Të mësuarit me projekte (Projekti)

Projekti kurrikular është strategji e të nxënës dhe mësimit dhe mësimit me në qendër nxënësin, përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti, si veprimtari integruar me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

Projekti kurrikular në lëndën e Teknologjisë me TIK, është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës.

- Zbatimi i një projekti në lëndën e Teknologjisë me TIK kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
- përcaktimi saktë i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë;
- përcaktimi qartë i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënë;
- grumbullimi i materialit dhe/ose mjeteve të nevojshme;
- përpunimi, analizimi dhe redaktimi i të dhënave të grumbulluara;
- nxjerrja e përfundimeve nga të dhënat e grumbulluara;
- përgatitja e produktit përfundimtar;
- prezantimi i projektit ose i produktit të krijuar.

4. IV. Organizimi i procesit të mësimit

Përdorimi i metodologjive efektive në procesin e të nxënës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku kërkohet përdorimi i njohurive për të zgjidhur situata konkrete nga jeta e përditshme. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe temave përkatëse mësimore. Mësimdhënien për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Mësimdhënien e Teknologjisë me TIK-un, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet:

- në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca;
- mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Ashtu siç e shpjegojmë në kapitullin më sipër, nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës sesi ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e Teknologjisë me TIK-un mban parasysh:

- ndërtimin e kompetencave kryesore të të nxënës në TIK;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive dhe shprehjeve për zgjidhje problemore dhe zhvillimin e mendimit kritik;
- zbatimin e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese, brenda dhe jashtë klases, të cilat lidhin konceptet lëndore me situata të jetës reale;
- përdorimin e mjeteve didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, printer, video-projektor etj..;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;

- zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës që në procesin mësimor, mësuesi/ja dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një planifikim i mirë krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit. Çdo model i planifikimit ditor është sugjerues, sepse kërkon të nxisë dhe orientojë mësuesit rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin orës mësimore, dhe për këtë arsye vendosja e rezultateve të të nxënësve për zhvillimin e kompetencave kyçe nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund të zhvillojë këtë situatë ose të zhvillojë temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij. Ato kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve përmes njohurive që ata kanë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësit të punojnë me situata dhe veprimtari reale që ata i njohin, ku i kërkojnë arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si:

- “Pse shërben Teknologjia me Tik-un në jetën e përditshme?”
- “A ndihmon Teknologjia me Tik-un në përmirësimin e aftësive tona, për të zhvilluar kompetenca që kërkon tregu i punës?”
- “Jam kurioz të njoh dhe zhvilloj aftësi që lidhen me multimedian dhe kërkimin në Internet?”

Në këtë mënyrë, ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara. Detyrat përmbledhëse, projektet individuale dhe në grup, kërkimet mbi çështje të ndryshme, gjykimet dhe qëndrimet personale janë një tjetër mënyrë që i krijojnë nxënësit mundësinë të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, si dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integrale me lëndë të tjera. Prezantimet e punimeve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave.

5. V. Materiale dhe burime mësimore

Për realizim më të suksesshëm të lëndës duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollë, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, internet, projekte të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune.

Mësimdhënësit mund të krijojnë portofola, apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme, përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative. Në librin e nxënësit gjenden ushtrime dhe aktivitete të shumta të cilën ndihmojnë mësuesin në implementimin e metodologjive interaktive në klasë. Ndërkohë në fletën e punës gjenden ushtrime që nxënësi zhvillon në mënyrë praktike njohuritë si dhe ushtrime për të pasuruar portofolin e të nxënësit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Mjetet audiovizive si: video, video-projektor, kompjuter, internet, USB, CD.
- Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.
- Mjedisi mësimor (klasa, kabinetet e Informatikës etj.)

6. VI. Lidhja ndërlëndore

Informacion i shkëputur nga Progami Lëndor i fushës Teknologji me TIK, Prishtinë 2019, MASHT.

Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të realizohet përmes:

- Gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit të ndonjëres nga kompetencat, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, ajo ndërlidhet edhe me çështje gjuhësore, letrare, teknologjike por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj. (shih në KB).

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet jashtëkurrikulare - një metodë ku nxënësit mund të zhvillojnë aktivitete jashtëmësimore p.sh.: vizita në laboratore të mekatronikës, në pyje, në fabrikë tekstili etj.

Metodologjia ndërlidhë përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxënit e fushave mësimore me rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele.

Thuajse, e gjithë veprimtaria e fushës Jeta dhe Puna bazohet në punën praktike. Metodatat që përdoren te kjo fushë duhet të mundësojnë konkretizimin e teorisë në praktikë.

Të nxënit në bashkëpunim bën të mundur që nxënësit të nxënë në mënyrë aktive dhe të shprehin shkathtësitë e tyre praktike. Të nxënit në bashkëpunim nxit të menduarit e rendit të lartë, ngre motivimin dhe moralin, mësohen shprehitë ndërvetjake, nxit mirëkuptimin midis nxënësve dhe grupeve etj.

Gjatë zbërthimit dhe përdorimit të metodologjive në orët mësimore, mund të përdoren dhe shumë teknika mësimore që përshtaten me pjesën hyrëse, realizimin e aktivitetit (përmabjtjes) dhe pjesën reflektuese me përdorimin e të menduarit kritik dhe përshtatjes së aktiviteve: Organizuesi veprues, Insert, Demonstrim, Shqyrtimi i përbashkët etj.

Të gjitha këto teknika mund të modifikohen varësisht nga njësia dhe kërkesa e përmbajtjes.

Është me rëndësi që secili mësimdhënës në lëndën Teknologji me TIK varësisht nga numri i nxënësve dhe njohuritë e tyre të identifikojnë drejtë përdorimin e secilës metodologji që dërgon deri te arritja e rezultateve.

Në kuadër të fushës kurrikulare Jeta dhe Puna, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj është realizimi i çështjeve ndërkurrikulare. Kjo do të ndihmojë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medies;
- Zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
- Barazia gjinore dhe toleranca;
- Puna vullnetare;
- Edukimi për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore;
- Shkathtësitë për jetë;
- Komunikimi ndërkurrikular përmes TIK-ut;
- Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie¹.

PLANI VJETOR (2020-2021)

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: VIII

Lëndët e fushës Kurrikulare I	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkollës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)	
	Shtator-tetor 17 orë	Nëntor-dhjetor 16 orë	Janar-shkurt 14 orë	Mars-prill (java 1) 15 orë	Prill- maj 8 orë	Qershor 4 orë
Lënda: Jeta dhe puna	1.Shkathrësitë e dizajnit (Paraqitja e trupave) (1.1-1.9)	2. Teknologjia e materialeve (2.8 – 2.11)	4. Pajisjet teknike/ teknologjike (4.6 – 4.8)	6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (6.4 – 6.17)	6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (6.18)	8. Ndërmarrësi i ri. (8.3-8.5)
		3. Mekanizmat dhe transmetuesit (3.1-3.6)	5. Teknologjia e transportit – Trafiku (5.1-5.7)		7. Karriera ime (7.1-7.5)	
Lënda: Jeta dhe puna	2. Teknologjia e materialeve - Materialet makinerike (2.1 – 2.7)	4. Pajisjet teknike/ teknologjike (4.1 – 4.5)	6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (6.1 – 6.3)		8. Ndërmarrësi i ri. (8.1-8.2)	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: VIII

Tema mësimore: 1.Shkathësië e dizajnit të trupave (Paraqitja e trupave), 2.Teknologjia e materialeve makinerike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 1:** (I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9) dhe **Tema 2:** (I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9)

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës 4 që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 1 & Tema 2** (1.2, 1.4, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 9.1, 9.2).

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burime
Tema 1 Shkathësitë e dizajnit (Paraqitja e trupave)	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon elementet e vizatimit teknik të objekteve. • Tregon llojet e prerjeve të paraqitura në materialin shkollor. • Përkthyer paraqitjen e thjeshtësuar dhe skematike të detaleve makinerike. • Vizaton projektionet aksonometrike, izometrike, dyometrike, të pjerrët. • Shpjegon projektionet aksonometrike, izometrike, dyometrike, të pjerrët dhe si paraqiten ato. • Ilustron shpalosjen e sipërfaqeve të formave të ndryshme. • Paraqet skema të thjeshta të dhëmbëzoreve. • Krijon sipërfaqe të ndryshme të shpalosura me të cilat krijohet një objekt. • Paraqet trupat 2D dhe 3D me vizatim teknik me vegla dhe programe kompjuterike. 	<p>1.1 Elementet e vizatimit teknik</p> <p>1.2 Skicat dhe skemat në vizatimin teknik</p> <p>1.3 Llojet e projektioneve</p> <p>1.4 Mënyrat e paraqitjes aksonometrike të objekteve</p> <p>1.5 Paraqitja e prerjes</p> <p>1.6 Skema të thjeshta të dhëmbëzoreve</p> <p>1.7 Shpalosja e sipërfaqeve të formave të ndryshme</p> <p>1.8 Punë praktike</p> <p>Krijimi i një trupi gjeometrik duke ndërtuar sipërfaqet e shpalosur</p> <p>1.9 Krijimi i një trupi gjeometrik nëpërmjet programeve kompjuterike</p>	9 orë	<ul style="list-style-type: none"> • Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë • Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët • Përfundimi i të nxënësve: (Përmes pyetjeve) • Punë praktike-kohë reale 	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi me listë kontrolli • Lista e kontrollit • Testimi • Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike • Kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe 	Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësve, fletoret e nxënësve, materiale nga interneti, materiale plotësuese Teksti i nxënësve

Tema 2	Teknologjia e materialeve - Materialet makinerike	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet llojet e veglave për përpunim të materialeve makinerike. • Harton masat mbrojtëse në punë për përdorimin e materialeve makinerike. • Tregon vetitë e materialeve makinerike (fizike, kimike, teknologjike), rëndësinë që ato kanë dhe përdorimin e tyre në teknologji. • Përkshkruan si prodhohen dhe përpunohen metalet dhe legurat (aliazhet) (lërimi, pastrimi, farkimi, derdhja, ngjitja, mbrojtja sipërfaqësore etj.) përmes proceseve teknologjike. • Përkshkruan përdorimin e metaleve bakri, zinku, plumbi, ari etj., si dhe krahason ato me materialet plastike. • Diskuton dhe përkshkruan përpunimin e metaleve: përgatitjen teknike (bën planifikimin), matjen dhe kontrollin, shkruarjen, lëimin, farkimin, pastrimin, ngjitja, mbrojtja sipërfaqësore. • Identifikon llojet e profileve të plota dhe tëzbrazëta ngamateriali i çelikut dhe hekurit. 	<p>2.1 Vetitë e materialeve makinerike, përdorimi i tyre në teknologji</p> <p>2.2 Metalet me ngjyrë dhe materialet plastike</p> <p>2.3 Llojet e veglave për përpunimin e materialeve makinerike dhe siguria në punë</p> <p>2.4 Prodhimi dhe përpunimi i metaleve përmes proceseve teknologjike</p> <p>2.5 Përpunimi i metaleve.</p> <p>2.6 Çeliku dhe llojet e proleve prej çeliku</p> <p>2.7 Matja përmes matësve të ndryshëm</p> <p>Përsëritje</p>	8 orë	<p>Hulumtim me kompjuter</p> <p>Metoda interaktive / ndërvepruese/ gjithëpërfshirëse</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Punë e drejtuar për të pasuruar portofolin e të nxënit.</p> <p>Tabela e konceptit/ veprimtari e drejtuar/provo veten.</p> <p>Harta e mendimit/ konceptograma</p> <p>Bashkëbisedim dhe ilustrim ose prezantim</p> <p>Rrjeti i diskutimit/vëzhgo analizo-diskuto/praktikë e pavarur</p>	<p>Vlerësimi me shkrim</p> <p>Vlerësimi me gojë</p> <p>Vlerësimi me anë të dëgjimit</p> <p>Vlerësimi praktik</p>	<p>Fletorja e nxënësit</p> <p>Materiale nga interneti</p> <p>Materiale plotësuese</p>
--------	---	---	---	--------------	--	--	---

PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: VIII

Tema mësimore: 2. Teknologjia e materialeve - Materialet makinerike

3. Mekanizmat dhe transmetuesit **4.** Pajisjet teknike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 2:** (I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9) **Tema 3:** (I.5, I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9 & **Tema 4:** (II.1, II.2, II.4, III.6, III.7, III.8),

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: Tema 2, 3 dhe 4 (1.2, 1.4, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 9.1, 9.2).

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burime
Tema 2 Teknologjia e materialeve	<ul style="list-style-type: none"> Përkshruan proceset e matjes së materialeve makinerike përmes matësve të ndryshëm. Përkshruan llojet dhe funksionin e makinave për përpunimin e metaleve (shpuese, zdrukthtuese, frezuese, ratifikuese, tornuese, me drejtim numerik etj.). Përkshruan pjesët përbërëse dhe funksionin e robotit. Përkshruan funksionin e Lego robotit si makinë programuese dhe e ndërton atë përmes programit kompjuterik. 	<p>2.8 Llojet e makinave metalprerëse dhe funksioni i tyre</p> <p>2.9 Roboti</p> <p>2.10 Roboti Lego dhe funksionet e tij .</p> <p>2.11 Programimi i robotit Lego</p>	4 orë	<p>Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët</p> <p>Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe</p>	<p>Vlerësimi me listë kontrolli</p> <p>Testimi</p> <p>Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike</p> <p>Kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe</p>	<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fletoret e nxënëseve, materiale nga interneti, materiale plotësuese.</p> <p>Teksti i nxënësit</p> <p>Fletoret e nxënëseve</p>

Tema 3 Mekanizmat dhe transmetuesit	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon llojet e mekanizmave lëvizës dhe transmetuesve bazuar në literaturën shkollore. • Përshkruan parimin e punës dhe funksionin e mekanizmave, makinave lëvizëse, transmetuesve, motorëve dhe përbërjen e tyre. • Ndërtton mekanizma të ndryshëm me leva, me gungë me materiale: druri, plastikë, letër, metal. • Krijon transmetuesit me rripa me dy rrota udhëzuese me diametër të ndryshëm. • Tregon disa lloje të motorëve me djegie të brendshme. • Përshkruan funksionin e motorëve me djegie të brendshme dhe të jashtme. • Analizon funksionin e motorëve me djegie të brendshme dhe të jashtme. 	3.1 Mekanizmat lëvizës dhe transmetues 3.2 Punë praktike Ndërtimi i mekanizmit me leva dhe i mekanizmit me gungë 3.3 Ndërtimi i transmetuesit me rrip dhe me dy rrota me diametra të ndryshëm 3.4 Motorët me djegie të jashtme 3.5 Motorët me djegie të brendshme 3.6 Funksioni i motorëve me djegie të brendshme	6 orë	Punë praktike-kohe reale Hulimtim me kompjuter Metoda interaktive/ ndërvepruese/ gjithëpërfshirëse Diskutim Rrjeti i diskutimit/ punë e drejtuar Harta e mendimit Teknika të vetëvlerësimit	Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren Vlerësimi i portofolit	Material nga interneti Material plotësues Materiale multimediale
--	--	---	--------------	---	---	--

Tema 4 Pajisjet teknike/ teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veglat për punë dhe pajisjet për mësimdhënie. • Dallon pajisjet teknike shpëtiqe nga ato që përdoren për mësimdhënie në shkollë • Identifikon pajisjet teknike për ngrohje dhe ftohje. • Tregon konstruktin e stufës termoakumuluese , klima pajisjes dhe mënyrën e përdorimit të tyre. • Tregon konstruksionin e shporetit elektrik, frigoriferit dhe pajisjet tjera si dhe mënyrën e përdorimit të tyre • Demonstron me shembuj konstruktin e lavatritës, bojlerit, hekurit elektrik,, mikserit dhe të pajisjeve tjera si dhe përdorimin e tyre në praktikë. • Diskuton punën që kryen makina rrobalarëse, bojleri, hekuri, mikseri etj. • Përshkruan masat mbrojtëse në punë me çdo pajisje teknike. 	<p>4.1 Mjetet dhe pajisjet për mësimdhënie</p> <p>4.2 Dallimi ndërmjet pajisjeve teknike shpëtiqe dhe atyre për mësimdhënie</p> <p>4.3 Pajisjet teknike për ngrohje dhe ftohje. Konstruksioni dhe përdorimi i tyre</p> <p>4.4 Pajisjet teknike shpëtiqe për përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit</p> <p>4.5 Pajisjet teknike për punë shpëtiqe dhe ngrohjen e ujit</p> <p>Përsëritje</p>	<p>6 orë</p>	<p>Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>Ndërtimi i njohurive:</p> <p>Diskutim i përbashkët</p> <p>Përforsimi i të nxënësve: Rishikim në dyshe</p>	<p>Testimi</p> <p>Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike</p> <p>Kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe</p>	<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fletoret e nxënësve, materiale nga interneti, materiale plotësuese.</p> <p>Teksti i nxënësit</p> <p>Fletoret e nxënësve</p>
--	---	---	---------------------	--	--	--

PLANI DYMUJOR: JANAR-SHKURT

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: VIII

Tema mësimore: 4. Pajisjet teknike/teknologjike, Tema 5. Teknologjia e Transportit, Tema 6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 4:** (II.1, II.2, II.4, III.6, III.7, III.8), **Tema 5:** (I.2, 2.1, III.2, IV.1, V.1, VII.1, VIII.1, IX.1), **Tema 6:** (I8, II1, II7, III6, III7, III8)

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 4** (1.2, 1.4, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 9.1, 9.2), **Tema 5** (1.2, 1.3, 4.1, 4.3, 6.1, 8.1, 9.1). **Tema 6** (1.2, 1.3, 4.1, 4.3, 6.1, 8.1, 9.1),

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burime
Tema 4 Pajisjet teknike/ teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> Tregon ndërtimin e shtrëpizës dhe monitorit të kompjuterit. Përkthejnë ndërtimin e një aparati digjital, projektori, TV i mençur, telefoni i mençur. Kryen aktivitete praktike me anë të pajisjeve teknike për mësimdhënie që ndodhen në kabinet 	<p>4.6 Shtëpiza dhe monitori i kompjuterit</p> <p>4.7 Projektori, televizori dhe telefoni i mençur</p> <p>4.8 Punë praktike Përdorimi i pajisjeve teknike në mësimdhënie</p>	3 orë	<p>Parashikimi i njohurive:</p> <p>Parashikimi me terma paraprakë</p> <p>Ndërtimi i njohurive:</p> <p>Diskutim i përbashkët</p> <p>Përfundimi i të nxënësve: Rishikim në dyshe</p>	<p>Vlerësimi me listë kontrolli</p> <p>Vlerësimi me teste ose detyra përmbledhëse</p> <p>Vlerësimi me dosje (portofoli)</p> <p>Vlerësimi me projekte</p> <p>Vlerësimi me foto apo albume përmbledhëse</p>	<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fletoret e nxënësve, materiale nga interneti, materiale plotësuese.</p>
Tema 5. Teknologjia e transportit – Trafiku	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon llojet e transportit tokësor, ujor dhe ajror. Përkthejnë rëndësinë e transportit dhe mjeteve të transportit. Paraqet grafikisht shenjat kryesore të trafikut dhe rolin e tyre në komunikacion. Përkthejnë rëndësinë e respektimit të rregullave në trafik. Përkthejnë përparësitë e disa llojeve të veçanta të transportit. Identifikon rreziqet e mundshme në trafik. Tregon detyrat që kryejnë sistemet drejtuese në transport. 	<p>5.1 Llojet e transportit</p> <p>5.2 Rëndësia e transportit në jetën tonë</p> <p>5.3 Përparësitë e disa llojeve të transportit.</p> <p>5.4 Shenjat kryesore të trafikut dhe roli i tyre në komunikacion</p> <p>5.5 Rëndësia e zbatimit të rregullave të trafikut</p> <p>5.6 Rreziqet e mundshme në trafik.</p> <p>5.7 Sistemet drejtuese në transport</p>	7 orë	<p>Hulumtim me kompjuter</p> <p>Bisedë/veprimtari e drejtuar/praktikë e pavarur</p> <p>Rikujtim i njohurive të marra/ pyetje dhe punë në grupe</p> <p>Tabelë konceptesh rreth Internetit/ demonstrim, punë e pavarur</p> <p>Veprimtari praktike</p>	<p>Vlerësimi me shkrim</p> <p>Vlerësimi me gojë</p> <p>Vlerësimi me anë të dëgjimit</p> <p>Vlerësimi praktik</p>	<p>Fletoret e nxënësve</p> <p>Teksti i nxënësit</p> <p>Fletorja e punës</p>

Tema 6 Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon rolin dhe funksionin e programit për llogaritje. • Përdor në mënyrë të pavarur programin për llogaritje të të dhënave. 	<p>6.1 Programet për llogaritjen tabelore (Spreadsheet).</p> <p>6.2 Njohja me programin Ms Excel</p> <p>6.3 Pjesët kryesore të dritares së programit Excel.</p> <p>Përsëritje</p>	4 orë	<p>Punë praktike-kohëreale</p> <p>Hulumtim me kompjuter</p> <p>Bisedë/veprimtari e drejtuar/praktikë e pavarur</p> <p>Rikujtim i njohurive të marra/pyetje dhe punë në grupe</p> <p>Tabelë konceptesh rreth Internetit/demonstrim, punë e pavarur</p> <p>Veprimtari praktike</p>	<p>Vlerësimi me shkrim</p> <p>Vlerësimi me gojë</p> <p>Vlerësimi me anë të dëgjimit</p> <p>Vlerësimi praktik</p>	<p>Material nga interneti</p> <p>Material plotësues</p> <p>Fletorja e punës</p>
--	--	---	--------------	--	--	---

PLANI DYMUJOR: MARS-PRILL

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: VIII

Tema mësimore: 6 . Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 6:** (I8, II1, II7, III6, III7, III8).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 6** (1.2,1.3, 4.1, 4.3, 6.1, 8.1, 9.1)

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burime
Tema 6 Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> Krijon detyra të ndryshme me llogaritje përmes programit kompjuterik. Krijon projekte të ndryshme digjitale për teknologjinë, mjedisin, materialet, bazë të dhënash etj., përmes programeve për llogaritjen e të dhënave. Inserton objekte të ndryshme për krijimin e prezantimeve dhe projekteve shkollore. Përdor programin për kalkullim me shembuj të gatshëm për krijimin e kalendareve, tabelës për projekt, orarin e punës etj. Krijon tabela, grafikonetë thjeshta dhe smart art për paraqitjen e të dhënave të ndryshme përmes programit kompjuterik. Përpunon, modifikon dhe komprimon fotografi përmes programeve kompjuterike. Krijon kolazhe të ndryshme me fotografi përmes programeve profesionale duke i modifikuar dhe ndryshuar sipas nevojës. Përpunon dhe organizon dokumente të ndryshme në formatin PDF. Përkrahin rolin e simuluesve (simulatorëve) digjitale në mësimdhënien efektive. Përdor simulatorë të ndryshëm për simulimin e aktiviteve të ndryshme teknologjike. 	<p>6.4 Editimi dhe formatimi i tabelës së punës në Excel</p> <p>6.5 Pune praktike Krijimi i një kalendari në Excel</p> <p>6.6 Përdorimi i shembujve të gatshëm në Excel</p> <p>6.7 Paraqitja e të dhënave në mënyrë grake</p> <p>6.8 Krijimi i grakëve SmartArt në Excel</p> <p>6.9 Përpunimi i imazhit nëpërmjet programeve kompjuterike (I)</p> <p>6.10 Përpunimi i imazhit nëpërmjet programeve kompjuterike (II)</p> <p>6.11 Njohja me programin Photoshop</p> <p>6.12 Përpunimi i imazhit nëpërmjet Photoshop-it</p> <p>6.13 Pune praktike Krijimi i një kolazhi fotografik</p> <p>6.14 Programi Adobe Acrobat dhe përpunimi i dokumenteve në format PDF</p> <p>6.15 Roli i simulatorëve digjitale në mësimdhënien</p> <p>6.16 Përdorimi i simulatorit Junior Simulation Insight</p> <p>6.17 Simulatori Floëgorithm dhe përdorimi i tij</p> <p>Përsëritje</p>	15 orë	<p>Përfundimi i të nxënësve: Rishikim në dyshe</p> <p>Punë praktike –kohë reale</p> <p>Hulumtim me kompjuter</p> <p>Tabela e konceptit/veprimtarisë drejtuar/provo veten</p> <p>Harta e mendimit/konceptograma</p>	<p>foto apo albume përmbledhëse</p> <p>Vlerësimi nëpërmjet buletinit pjesëmarrës</p> <p>Vlerësimi praktik</p> <p>Vlerësimi i portofolit</p>	<p>Teksti i nxënësve</p> <p>Material nga interneti</p> <p>Material plotësues</p> <p>Fletorja e punës</p>

PLANI DYMUJOR: MAJ-QERSHOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: VIII

Tema mësimore: 6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit, Tema 7. Karriera ime, Tema 8. Ndërrmarrësi i ri

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 6:** (I8, II1, II7, III6, III7, III8), **Tema VII:** (I.1, I.2, II.1, III.1, III.2, IV.1, IV.2, VI.1, VII.1, VIII.1, VIII.2), **Tema 8:** ((I.1, I.2, II.1, III.1, III.2, IV.1, IV.2, VI.1, VII.1, VIII.1, VIII.2).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 6** (1.2, 1.3, 4.1, 4.3, 6.1, 8.1, 9.1) **Tema 7** (1.1, 2.1, 7.1, 8.1), **Tema 8** (1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 9.2).

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burime
Tema 6 Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> Krijon simulatore të ndryshëm përmes programeve kompjuterike. 	6.18 Punë praktike Krijimi i simulatorëve nëpërmjet programit Scratch .	1 orë mësimore	Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë	Vlerësimi me dosje (portofoli)	Teksti I nxënësit materiale nga interneti, materiale plotësuese
Tema 7 Karriera ime	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare. Identifikon dhe vlerëson interesat, shkathësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm. Krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathësitë për karrierën e tij të ardhshme. Analizon dhe përdor burimet e ndryshme të informimit për karrierë. Hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathësitë të tij/saj. 	7.1 Shërbimi vullnetar 7.2 Zgjedhja e profesionit 7.3 Planikimi i një projekti 7.4 Informimi për karrierë 7.5 Shkathësitë e nevojshme për të ardhmen	5 orë	Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët Përfundimi i të nxënit: Rishikim në dyshe Punë praktike-kohë reale Hulumtim me kompjuter Portofoli e nxënësit Veprimtari Praktike Punë individuale Klaster	Vlerësimi me listë kontrolli Vlerësimi me teste ose detyra përmbledhës Vlerësimi me projekte Vlerësimi me foto apo albume përmbledhës Vlerësimi me shkrim Vlerësimi me gojë Vlerësimi me anë të dëgjimit Vlerësimi praktik Vlerësimi i portofolit	Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fletoret e nxënëseve, Teksti i nxënësit

Tema 8 Ndërmarrësi i ri	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon llojet e tregut vendor. • Identifikon interesat dhe nevojat. • Përkruan punën e ndërmarrësit në biznes. • Krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur) • Përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara. • Përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut). 	8.1 Identifikimi i tregjeve 8.2 Roli i ndërmarrësit në biznes 8.3 Si të zhvillojmë shpirtin sipërmarrës 8.4 Plani i biznesit 8.5 Funksionet e sipërmarrjes Përsëritje	6 orë	Hulumtim me kompjuter Bisedë/veprimtari e drejtuar/praktikë e pavarur Rikujtim i njohurive të marra/pyetje dhe punë në grupe Tabelë konceptesh rreth Internetit/ demonstrim, punë e pavarur Veprimtari praktike Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë Bashkëbisedim dhe ilustrim ose prezantim	Vlerësimi me listë kontrolli Vlerësimi me teste ose detyra përmbledhës Vlerësimi me dosje (portofoli) Vlerësimi me projekte Vlerësimi me foto apo albume përmbledhës	Fletoret e nxënësve Material nga interneti Material plotësues
--	---	--	--------------	---	--	---

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna		Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Shkathhtësitë e dizajnit (Paraqitja e trupave)			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon elementet e vizatimit teknik të objekteve;- tregon llojet e prerjeve të paraqitura në materialin shkollor;- përshkruan paraqitjen e thjeshtësuar dhe skematike të detaleve makinerike;- vizaton projeksionet, aksonometrike, izometrike, dymetrike, të pjerrët;- shpjegon projeksionet aksonometrike, izometrike, dymetrike, të pjerrët dhe si paraqiten ato;- ilustron shpalosjen e sipërfaqeve të formave të ndryshme;- paraqet skema të thjeshta të dhëmbëzoreve;- krijon sipërfaqe të ndryshme të shpalosura me të cilat krijohet një objekt;- paraqet trupat 2D dhe 3D me vizatim teknik me vegla dhe programe kompjuterike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme 1.1 Përdor vegla, pajisje dhe makina punuese bazuar në udhëzime dhe doracakë për përdorim. 1.2 Përshkruan procesin teknologjik të shfrytëzimit të burimeve natyrore të energjisë.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: 1.1. Elementet e vizatimit teknik				
Tema 7: Karriera ime		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon shërbimet vullnetare në rrethin (komunitetin) ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare;- identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij/saj të ardhshëm;- krijon dhe zbaton planin e projektit përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij/saj të ardhshme;- hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj.- analizon dhe përdor burime të ndryshme të informimit për karrierë.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore 1: Shërbimi vullnetar				
Fjalë kyçe: vullnetarizmi formal dhe joformal, përfitimet e vullnetarizmit.				
Rezultati i të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon shërbimet vullnetare në rrethin (komunitetin) ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare. Kriteret e suksesit: <ol style="list-style-type: none">1. Cilat janë format më të mira për të punuar si vullnetar?2. Cilat janë përfitimet kryesore që vijnë falë punës vullnetare?				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të përfitimeve që vijnë falë punës si vullnetar/e. Gjithashtu, zhvillon kompetencën e zgjidhjes së problemeve për të punuar në sektorin ku ka aftësitë kryesore.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE				

Situata e të nxenit: Bashkëbisedim, punë në grupe

Për realizimin e kësaj teme, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë ...

A keni dëgjuar ju për punën vullnetare? A njihni njerëz që punojnë si vullnetarë? Si mendoni, cilat janë disa nga përfitimet kryesore që vijnë falë punës vullnetare?

Mësuesi/ja mban ndërkohë shënime në një fletë *flipchart*, të cilat mund t'i rishohë në fund të mësimit.

Situata e të nxënës (Veprimet në situatë) – Përshkrimi kontekstual i situatës:

Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë e marra ose falë informacionit që mund të kenë lexuar më parë për këtë tematikë. Diskutohet bashkë me mësuesin/en edhe situata e paraqitur në libër nëpërmjet rubrikës “Aktivitet”.

Hapi I – Rrjeti i diskutimit – Identifikimi i problemit

Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë që kanë marrë më parë, si dhe duke lexuar informacionin në tekst. Për nxënësit është shumë e rëndësishme që të ndajnë çfarë informacioni është parësor dhe çfarë është informacion dytësor.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto: Kategorizimi i problemit

Nëpërmjet videoprojektorit, mësuesi/ja shpjegon përkufizimin e termit *vullnetar*, llojet dhe përfitimet e punës vullnetare. “Aktivitet”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë t'u përgjigjen pyetjeve konkrete mbi vullnetarizmin; janë në gjendje të shohin rëndësinë e tij në jetën e përditshme, si dhe mund të kenë dëshirë për të punuar si vullnetarë në të ardhmen.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**Punë në dyshe/ Praktikë e pavarur**

Nxënësit kontrollojnë njohuritë e përvetësuara gjatë orës së mësimit, duke i bërë pyetje njëri-tjetrit për disa minuta.

Hapi II

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën “Provo veten”

Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.

Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna. Nëse ndonjë prej tyre nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtar i tjetër i grupit për një përgjigje më të qartë dhe të plotë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna		Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema 7: Karriera ime		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon shërbimet vullnetare në rrethin (komunitetin) ku jeton, dhe analizon mënyrën e punës vullnetare;- identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm;- krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme;- hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj;- analizon dhe përdor burime të ndryshme të informimit për karrierë.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës RNF 7:				
7. 1. Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore 2: Zgjedhja e profesionit				
Fjalë kyçe: <i>interesat për punë, shkathtësitë, aftësitë, profesioni i ardhshëm.</i>				
Rezultati i të nxënit për orën mësimore:				
Nxënësi/ja:				
- identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij/saj të ardhshëm.				
Kriteret e suksesit:				
Nxënësi/ja:				
1. është në gjendje të kërkojë informacion, si dhe të vlerësojë aftësitë dhe shkathtësitë;				
2. bashkon për printim në një fletë të vetme të gjitha kolonat e tabelës në <i>Excel</i> .				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori), printeri.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare: me lëndë të ndryshme, ku diskutohet rreth profesioneve dhe aftësive të nevojshme për to. Nxënësi/ja zhvillon konceptet se si TIK-u mund të ndihmojë në gjetjen e punës dhe se si mund të fitosh aftësi të shekullit XXI nëpërmjet përdorimit të TIK-ut.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE				

Për të realizuar këtë orë mësimore, mësuesi/ja hedh për diskutim këto pyetje: Cilat janë profesionet më të kërkuara në tregun e punës? Si i ka ndryshuar teknologjia disa profesione? Si mendoni, cilat janë aftësitë kyçe, të nevojshme, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës?

Situata e të nxënës (Veprime në situatë)

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit gjatë diskutimit në klasë japin përgjigje duke përdorur njohuritë që marrin në libër, por edhe duke përdorur disa nga informacionet që kanë te fleta e punës. Me anë të videoprojektorit në laboratorin e Informatikës, mësuesi/ja demonstroi hapat përkatës të temës së mësimi. Më pas nxënësit punojnë individualisht për të provuar komandat e mësuara më lart.

Hapi I – Rrjeti i diskutimit - Identifikimi i problemit

- Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë, si dhe duke u orientuar nga ajo që tregohet në videoprojektor.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto/ Kategorizimi i problemit

Diskutohet rreth rubrikës “Aktivitet” dhe mënyrave që jepen në rubrikat përkatëse për printimin e një materiali të përgatitur.

Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur

Te rubrika “Provo veten”, nxënësit kontrollojnë njohuritë e përvetësuara gjatë kësaj ore mësimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit realizojnë printimin e saktë dhe të qartë të materialit, duke ekonomizuar edhe bojën e printerit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Printoni një dokument që keni përgatitur si detyrë në një lëndë të caktuar gjatë javës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE Data: _____			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema 7: Karriera ime	Rezultatet e të nxënës të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon shërbimet vullnetare në rrethin ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare; - identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij/saj të ardhshëm; - krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij/saj të ardhshme; - hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj; - analizon dhe përdor burime të ndryshme të informimit për karrierë. 		

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2
Rezultatet e fushës së kurrikulës RNF 2: 2. 1 Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore 3: Planifikimi i një projekti
Fjalë kyçe: <i>projekt, hapat e projektit, suksesi, profesioni.</i>
Rezultati i të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: - krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij/saj të ardhshme. Kriteret e suksesit: Nxënësi/ja: 1. njeh nocionet dhe parimet e projektit; 2. është në gjendje të hartojë një projekt.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të projektit, si dhe format e ndryshme për të planifikuar projekte për tematika të ndryshme.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim situatën e mëposhtme: Zgjidhni një temë për të bërë një projekt. Vendosini projektit tuaj një titull. Argumentoni arsyet në lidhje me përzgjedhjen e temës. Më pas, nxënësit diskutojnë në klasë rreth titujve që u kanë vendosur projekteve. Së bashku me mësuesin/en, përzgjidhen titujt më të mirë. Argumentohet përzgjedhja. Hapi I – Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit - Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë më parë. Nga mësuesi/ja demonstrohen mënyrat apo format e duhura për të shkruar (hartuar) një projekt të suksesshëm. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Duke ndjekur tabelën dhe shembullin në libër me rezultatet e nxënësve në lëndë të ndryshme, paraqitet mënyra e duhur për të ndërlidhur shkrimin e projektit me profesionin. Duke u bazuar tek shënimet që janë mbajtur në fletën e <i>flipcharter</i> -it, në bashkëpunim me të gjithë nxënësit e klasës vendoset se cilët janë titujt e duhur për projekte, duke argumentuar përgjigjen për çdo rast. Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja i ndihmon në lidhje me hapat që ndiqen për zgjidhjen e problemeve.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të kryejnë me sukses punët në grup (në klasë), si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Klasa ndahet në dy grupe; nxënësit plotësojnë rubrikën “Provo veten”.

Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1.

Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.

Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna. Nëse ndonjëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtar i tjetër i grupit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një projekt duke zbatuar fazat e shpjeguara në këtë mësim.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna		Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema 7: Karriera ime		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare;- identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm;- krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme;- hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj;- analizon dhe përdor burime të ndryshme të informimit për karrierë.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin. 2. 2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup. 2.4. Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: 7.4 Informimi për karrierë				
Fjalët kyçe: profesionet, karriera, panaiet e punësimit, mundësi zhvillimi.				

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- njeh dhe përdor burimet e ndryshme të informimit për karrierë.

Kriteret e suksesit:

1. Njeh burimet për të zhvilluar karrierën.
2. Analizon burimet për të krijuar mundësi zhvillimi për të ardhmen.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë kohës së kërkimit të profesioneve në zyrën e karrierës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Bashkëbisedim, punë në grupe

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë...

Cili do të ishte profesioni juaj i preferuar në të ardhmen? Cilat janë burimet që ju do të përdornit për të gjetur profesionin tuaj për të ardhmen? A kanë dëgjuar ata për panairin e punësimit? A kanë vizituar ata një panair të tillë?

Hapi I –Rrjeti i diskutimit, Identifikimi i problemit

Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë më parë. Nga mësuesi/ja demonstron mësimi i ri nëpërmjet përdorimit të internetit dhe mënyrës se si mund të kërkohet informacion rreth punësimit.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Duke ndjekur tabelën dhe shembullin në libër, nxënësit kërkojnë informacion rreth profesioneve të tyre të preferuara. Mësuesi/ja përdor ushtrimin në fletën e punës dhe më pas ata diskutojnë rreth formave më të suksesshme për të gjetur punën e ëndrrave. Gjithashtu, ata kuptojnë rëndësinë e rrjetimit për të pasur më shumë mundësi punësimi.

Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja i ndihmon në lidhje me hapat që ndiqen për zgjidhjen e problemeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të realizojnë me sukses punët në grup në klasë, si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Realizoni projektin e dhënë në libër duke zhvilluar intervista të shkurtra me familjarët tuaj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna		Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema 7: Karriera ime			Rezultati i të nxënës të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare;- identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm;- krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme;- hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj;- analizon dhe përdor burime të ndryshme të informimit për karrierë.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin. 2. 2. Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup. 2.4. Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: 7.5 Shkathtësitë e nevojshme për të ardhmen				
Fjalët kyçe: profesionet, karriera, panaiet e punësimit, mundësi zhvillimi.				
Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- hulumton tregun e punës dhe përzgjedh profesionin në bazë të aftësive dhe shkathtësive që zotëron. Kriteret e suksesit: <ol style="list-style-type: none">1. Njeh aftësitë për të zgjedhur profesionin e duhur.2. Është një gjendje të vlerësojë shkathtësitë dhe rëndësinë e marrjeve të vendimeve.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë kohës së zhvillimit të aftësive.				

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Bashkëbisedim, punë në grupe

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë...

Mësuesi/ja përdor për të realizuar diskutimin ushtrimin që u ka dhënë nxënësve në mësimin e mëparshëm.

Hapi I: Rrjeti i diskutimit, identifikimi i problemit

Bazuar tek aftësitë që nxënësit kanë mbajtur shënim në detyrat e shtëpisë, mësuesi/ja u kërkon që ata të bëjnë kategorizimin e aftësive duke u bazuar, p.sh., te disa profesione.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Nxënësit diskutojnë më pas, se si disa aftësi janë më të rëndësishme në një profesion dhe si disa aftësi janë të domosdoshme në disa profesione të caktuara.

Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja i ndihmon në lidhje me hapat që ndiqen për të njohur më mirë aftësitë e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të realizojnë me sukses punët në grup në klasë, si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Realizoni projektin e dhënë në libër, duke zhvilluar intervista të shkurtra me familjarët tuaj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE Data: _____

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema 8: Ndërmarrës i ri	Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon llojet e tregut vendor; - identifikon interesat dhe nevojat; - përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes; - krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur); - përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara; - përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut). 		

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2

Rezultatet e fushës së kurrikulës RNF 5:

5.1. Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit.

Rezultatet e fushës së kurrikulës RNF 7:

7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore 1: Identifikimi i tregjeve

Fjalë kyçe: *llojet e tregjeve, interesat dhe nevojat e tregut, funksionimi i tregut.*

Rezultati i të nxënit për orën mësimore:

Nxënësi/ja:

- identifikon llojet e tregjeve, si dhe njeh nevojat dhe interesat e tij.

Kriteret e suksesit:

Nxënësi/ja:

1. njeh nocionet e para të tregut, biznesit;
2. dallon llojet e tregjeve, nevojat dhe interesat e tregut.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të llojeve të tregjeve, si dhe gjatë diskutimit për nevojat dhe interesat e tregut.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Bashkëbisedim, punë në grupe. Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim pyetjet si më poshtë...

A dilni për Pazar me prindërit? Shkoni në treg për të blerë fruta/zarzavate? Çfarë ju pëlqen më shumë gjatë kohës që jeni në treg?

Hapi I –Rrjeti i diskutimit – Identifikimi i problemit

- Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë e marra gjatë diskutimeve që kanë pasur në përditshmërinë e tyre. Nga mësuesi/ja demonstrohen llojet e tregjeve dhe nga ndryshojnë prej njëri-tjetrit.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto – Kategorizimi i problemit

Bazuar në tabelën dhe shembullin e dhënë në libër, mësuesi/ja analizon se nevojat dhe interesat në tregje të ndryshme janë të ndryshme. Diskuton me nxënësit nëse këta kanë vizituar tregjeve të llojeve të ndryshme.

Hapi III: Punë në dyshe/ Praktikë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja i ndihmon në lidhje me hapat që ndiqen për zgjidhjen e problemeve. Është shumë e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë mënyrën se si funksionojnë tregjet, duke u nisur edhe nga njësitë mësimore të temës së kaluar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të kryejnë me sukses punët në grup (në klasë), si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Shkruani një projekt duke zbatuar fazat që u shpjeguan në këtë mësim.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** Data: _____

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Teknologji me TIK

Shkalla e kurrikulës: IV

Klasa: VIII

Tema 8: Ndërmarrës i ri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Nxënësi/ja:

- identifikon llojet e tregut vendor;
- identifikon interesat dhe nevojat e tregut;
- përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes;
- krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur);
- përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara;
- përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2

Rezultatet e fushës së kurrikulës RNF 5:

5.1. Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore 2: Roli i ndërmarrësit në biznes

Fjalë kyçe: ndërmarrës, karakteristikat e ndërmarrësit, sipërmarrje, Startup.

Rezultati i të nxënit për orën mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan punën dhe rolin e ndërmarrësit në biznes.

Kriteret e suksesit:

Nxënësi/ja:

1. njeh karakteristikat e ndërmarrësit;
2. dallon llojet e sipërmarrjes, si dhe rëndësinë e Startup-eve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët, pasi do duhet të jetë ndërmarrës, si dhe të dijë të komunikojë për të shitur produkte të konsumatori.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve rëndësinë që ka në shekullin XXI sipërmarrja. Para se të shpjegohet koncepti i sipërmarrjes, mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth termit *ndërmarrës*. Shtrohet për diskutim pyetja: Cilat janë karakteristikat kryesore të ndërmarrësit?

Hapi I – Rrjeti i diskutimit – Identifikimi i problemit

- Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që kanë. Nga mësuesi/ja demonstrohen njohuritë e librit, duke i shoqëruar ato me disa shpjegime praktike. Për shembull, si kanë ndryshuar profesionet sot? Cilat janë profesionet më të kërkuara? Cilat janë aftësitë që kërkohen në shekullin XXI?

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto – Kategorizimi i problemit

Bazuar në tabelën dhe shembullin në libër, mësuesi/ja analizon se si kanë ndryshuar nevojat dhe interesat e tregut me kalimin e kohës, si dhe shpjegon me hollësi konceptet *ndërmarrës* dhe *sipërmarrje*.

Hapi III: Punë në dyshe/ Praktikë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër, si dhe në fletën e punës. Ndajnë gjetjet me njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë përvojat.

Nëse në të njëjtën periudhë, në Kosovë do të jetë duke u zhvilluar panairi i *Startup*-eve, do të ishte e këshillueshme që nxënësit të merrnin pjesë, për të krijuar ide me të qarta rreth asaj që kanë mësuar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të kryejnë me sukses punët në grup (në klasë), si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Shkruani një projekt duke zbatuar fazat që u shpjeguan në këtë mësim.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII	
Tema 8: Ndërmarrësi i ri	Rezultati i të nxënësve të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon llojet e tregut vendor;- identifikon interesat dhe nevojat;- përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes;- krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur);- përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara;- përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).			
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2				

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin. 2. 2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup. 5.1 Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit. 7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: 8.3 Si të zhvillojmë shpirtin sipërmarrës
Fjalët kyçe: sipërmarrës, sipërmarrje e vogël, biznes i ri.
Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - krijon dhe jep ide për nxitjen e shpirtit sipërmarrës. Kriteret e suksesit: 1. Njeh karakteristikat e shpirtit sipërmarrës. 2. Krijon në mënyrë autonome një plan biznesi.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori).
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikën. Nxënësit përdorin logjikën problemzgjedhëse për të krijuar plane biznesi dhe për të krijuar sipërmarrje të vogla.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi u shpjegon nxënësve rëndësinë që ka në shekullin XXI sipërmarrja dhe sa i rëndësishëm është shpirti sipërmarrës për të krijuar plane biznesi. Hapi I: Rrjeti i diskutimit, Identifikimi i problemit Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që ata kanë. Nga mësuesi/ja demonstrohen njohuritë e librit, duke i shoqëruar ato me disa shpjegime praktike. Gjithashtu, mësuesi/ja shpjegon që edhe në një sipërmarrje bashkëpunimi, komunikimi dhe planifikimi janë bazat e suksesit.
Hapi II: Vëzhgo–Analizo–Diskuto, Kategorizimi i problemit Duke ndjekur tabelën dhe shembullin në libër, mësuesi/ja bën një analizë se si mundet që nxënësit të krijojnë një biznes të vogël. Por, gjithashtu, u shpjegon edhe rëndësinë që ka sot teknologjia në zhvillimin e biznesit, pasi të rinjtë janë gjithnjë e më shumë në kontakt të ngushtë me teknologjinë.
Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër si dhe në fletën e punës. Ndajnë gjetjet me njëri-tjetrin, si dhe shkëmbejnë përvojat.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të realizojnë me sukses punët në grup në klasë, si dhe detyrat e shtëpisë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Teknologji me TIK	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII	
Tema 8: Ndërmarrësi i ri	Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon llojet e tregut vendor;- identifikon interesat dhe nevojat;- përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes;- krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur);- përpilon plan biznesi të thjeshtë (<i>simple</i>) me idetë e planifikuara;- përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).			
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin. 2. 2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup. 5.1 Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit. 7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: 8.4 Plani i biznesit				
Fjalët kyçe: plan biznes, analiza e tregut, produkti, shërbimi				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- përpilon një plan biznesi të thjeshtë, bazuar në ide të qarta dhe të mirëpërcaktuara. Kriteret e suksesit: <ol style="list-style-type: none">1. Kryen në mënyrë autonome një analizë të thjeshtë tregu.2. Krijon në mënyrë autonome një plan biznesi.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikën. Nxënësit përdorin logjikën problemzgjidhëse për të krijuar plane biznesi.				

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve rëndësinë që ka në shekullin XXI ndërtimi i bizneseve të vogla dhe se si sot të rinjtë janë të orientuar drejt biznesit.

Hapi I: Rrjeti i diskutimit, Identifikimi i problemit

Mësuesi/ja shpjegon çfarë është një plan biznesi, sa i rëndësishëm është plani në zhvillimin dhe ngritjen e biznesit dhe rëndësia e përshkrimit të duhur të produktit për të arritur suksesin.

Hapi II: Vëzhgo–Analizo–Diskuto, Kategorizimi i problemit

Duke ndjekur hapat dhe informacionet në libër, mësuesi/ja krijon 3 grupe dhe secilit grup i kërkon të krijojë një produkt për të cilin ka nevojë tregu. Në të njëjtën kohë, i kërkon secilit grup të hartojë një plan biznesi për të promovuar produktin.

Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur

Grupet prezantojnë punën e tyre dhe provojnë të jenë bindës për të promovuar produktin e tyre. Në këtë mënyrë, ata mësojnë nga njëri-tjetri strategji të ndryshme për të promovuar bizneset e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të realizojnë me sukses punët në grup në klasë, si dhe detyrat e shtëpisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** Data: _____

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda:
Teknologji me TIK

Shkalla e kurrikulës: IV

Klasa: VIII

Tema 8: Ndërmarrësi i ri

Rezultati i të nxënësit të temës:

Nxënësi/ja:

- identifikon llojet e tregut vendor;
- identifikon interesat dhe nevojat;
- përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes;
- krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur);
- përpilon plan biznesi të thjeshtë (*simple*) me idetë e planifikuara;
- përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës:

1.1, 1.2, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2

<p>Rezultatet e fushës së kurrikulës:</p> <p>2. 1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.</p> <p>2. 2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.</p> <p>5.1 Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot-plane të biznesit, individualisht apo në grup, dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit.</p> <p>7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.</p>
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: 8.5 Funksionet e sipërmarrjes
Fjalët kyçe: loja e monopolit, shkëmbimi i valutës, imitimi i tregut.
<p>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton përmes lojërave të ndryshme funksionet e sipërmarrjes (loja e monopolit, shkëmbimi i valutës, imitimi i tregut). <p>Kriteret e suksesit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kupton njohuritë nëpërmjet lojës së monopolit. 2. Vlerëson mënyrën se si funksionon ekonomia e tregut.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, një lojë monopol.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikën. Nxënësit përdorin logjikën problemzgjidhëse për të zhvilluar lojën, e cila bazohet në konceptet e konkurrencës dhe të ekonomisë së tregut.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
<p>Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve rëndësinë e analizës së ekonomisë së tregut, për të kuptuar më mirë konceptet e mësuara në mësimet e mëparshme.</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit, Identifikimi i problemit</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon rregullat në lojën e monopolit dhe, gjithashtu, ajo shpjegon se si kjo lojë lidhet ngushtë me konceptet e ekonomisë së tregut.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo–Analizo–Diskuto</p> <p>Nxënësit ndjekin hapat për të marrë pjesë në lojë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin, cilat janë disa nga aftësitë që ata zhvillojnë gjatë kohës që luajnë.</p> <p>Hapi III: Argumentim</p> <p>Anëtarët që fitojnë vendin e parë në secilin grup, i shpjegojnë anëtarëve të tjerë strategjinë që ata ndoqën për të fituar lojën. Gjithashtu, argumentojnë edhe zgjedhjet që ata bënë për të fituar lojën.</p>
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të realizojnë me sukses punët në grup në klasë si dhe detyrat e shtëpisë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PROJEKTI KURRIKULAR

- Projekti kurrikular në lëndën Teknologji me TIK është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës.
- Projekti kurrikular është strategji e të nxënës dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruar me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e Teknologji me TIK. kërkon më shumë se një orë mësimore, të cilën nxënësi e realizon në shtëpi.
- Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë edhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai e ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje instrumentin për vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është dicka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënë (është mjaft e rëndësishme që secili nxënë të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënës që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.
- Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.
- Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkime, grumbullim të dhënash, intervista, puna në grup, puna individuale etj.
- Stadet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
 - Përcaktimi saktë i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
 - Përcaktimi qartë i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënë.
 - Grumbullimi i materialit dhe/ose mjeteve të nevojshme.
 - Përpunimi, analizimi dhe redaktimi i të dhënave të grumbulluara.
 - Nxerrja e përfundimeve nga të dhënat e grumbulluara.
 - Përgatitja e produktit përfundimtar.
 - Prezantimi i projektit ose i produktit të krijuar.

- Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditë orë të planifikuara të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- **Tema e projektit** (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore** (Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- **Klasa/t pjesëmarrëse:** (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- **Rezultatet e të nxënësve** – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:** (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojnë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- **Partnerët** (mund të jenë prindërit, mësuesit e lëndëve të tjera, ose aktorë që punojnë në fushën e TIK-ut).
- **Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.**
- **Burimet kryesore të informacionit** (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit).

Shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit:

• A është fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?
• A është lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?
• A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?
• A kanë mbledhur të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?
• A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetmenaxhuese dhe organizuese?

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësor për të nxënësin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Katalogimi në botim (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:62(072)(075.2)

Sina, Irida

Libër për mësuesin : teknologjia me TIK 8 : për klasën e 8-të të
arsimit 9-vjeçar / Irida Sina. - Prishtinë : Pegi, 2021. - 137 f. :
ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

ISBN 978-9951-786-20-1